



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0005970/26 dt. 02.02.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Kërkesën Elektronike nga z. Shkelzen Haliti – Kabineti i Kryetarit, dt. 28.01.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024)

1. **FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024, në këtë përbërje:
 - 1.1 Bedri Muja – kryetar (Drejtorja e Inspekcionit);
 - 1.2 Lumturije Brahimi – anëtare (Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë);
 - 1.3 Albana Azemi – anëtare (Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë).
2. Komisioni është përgjegjës që të bëj ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024, duke shqyrtuar propozimet për ndryshime nga Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë Komunale, dhe të bëj harmonizimin e këtyre ndryshimeve sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores për Ndryshimin e Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullorën (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e



Akteve të Komunës, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Rregulloren Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale, e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

- 5 Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
- 6 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

Shtojcë:

1x1 Kërkesa Elektronike nga z. Shkelzen Haliti – Kabineti i Kryetarit, dt. 28.01.2026.

T'i dërgohet:

1x1 Kryetari të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit

